

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 4857 Rep.
Nr. 1831 Kol.



KONTRATE

(Për transferimin e aksioneve të shoqërisë "SIGMA" Sh.a)

Sot në Tiranë me datë 16.07.2006 (dymijë e gjashtë), përpara meje noterit të Dhomës së Noterëve Tiranë, u paraqiten personalisht palët e mëposhtme:

SHITESI: Z. Dod Doçi, shtetas shqiptar, lindur në Lurë të Rrethit të Dibrës, me datë 10.12.1956, identifikuar me pasaportën nr. Z1681668, madhor e me zotësi të plote për të vepruar.

Dhe

BLERESI: Z. Hydajet Rusta, shtetas shqiptar, lindur në Elbasan me datë 13.03.1960, mbajtës i pasaportës nr. Z0562100, madhor e me zotësi të plote për të vepruar. Z0562100

MEQENESE

- a) Shoqëria "SIGMA" Sh.a (Shoqëria), është një shoqëri anonime e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj në bazë të legjislacionit shqiptar, regjistruar në regjistrin tregtar me vendimin nr. 20487 datë 30.12.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë;
- b) Shoqëria "SIGMA" Sh.a ka një kapital të regjistruar në vlerën Lek 271.890.000 (dyqind e shtatëdhjetë e një milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë) i ndarë në 30.000 (tridhjetë mijë) aksione me vlerë nominale 9.063 (nëntë mijë e gjashtëdhjetë e tre) Leke secili;
- c) Shitësi zotëron 6.300 (gjashtë mijë e treqind) aksioneve, me vlerë nominale të përgjithshme prej 57.096.900 (pesëdhjetë e shtatë milion e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind) Leke, që përbejnë 21% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
- d) Shitësi dhe Blerësi kanë rënë dakord që Shitësi t'i shesë Blerësit 600 (gjashtëqind) aksione, me vlerë nominale të përgjithshme prej 5.437.800 (pesë milion e katërqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind) Leke, që përbejnë 2% të kapitalit të Shoqërisë;
- e) Aksionet shiten (transferohen) me vlerën e tyre nominale siç është përcaktuar me poshtë në këtë kontratë.

ATEHERE, palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

NENI 1.

OBJEKTI I KONTRATËS

Me nënshkrimin e kësaj kontrate e sipas kushteve vijuese, Shitësi i shtet Blerësit dhe ky i fundit pranon të blejë nga Shitësi 600 (gjashtëqind) aksione të shoqërisë SIGMA Sh.a, që përbejnë 2% të kapitalit të Shoqërisë;

NENI 2.

ÇMIMI I SHITJES

Aksionet e përcaktuara ne nenin 1, shiten (transferohen) kundrejt vlerës se tyre nominale prej 9.063 (nëntë mijë e gjashtëdhjetë e tre) Lekë secili, për një vlerë të përgjithshme prej 5.437.800 (pesë milion e katërqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind) Lekë.

Çmimi i shitjes i është paguar Shitësit plotësisht nga Blerësi jashtë zyrës noteriale.

NENI 3.

TRANSFERIMI I PRONËSISË MBI AKSIONET

Pronësia mbi aksionet transferohet menjëherë nga Shitësi tek Blerësi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

NENI 4.

TE NDRYSHME

Shitësi garanton se aksionet qe transferohen nëpërmjet kësaj kontrate janë te lira nga çdo barre.

Pas transferimit te pjesëve te kapitalit tek Blerësi, Z. Hydajet Rusta, behet pronar i ligjshëm i 600 (gjashtëqind) aksioneve, që përbejnë 2% të kapitalit të Shoqërisë, ndërsa Shitësi mbetet pronar i 5.700 (pesë mijë e shtatëqind) aksioneve të shoqërisë, që përbejnë 19% të kapitalit të Shoqërisë.

NENI 5.

BAZA LIGJORE

Kjo kontrate, e cila hartohet ne 4 kopje, do te interpretohet dhe zbatohet ne përputhje me dispozitat e Kodit Civil te Republikës se Shqipërisë dhe te ligjit nr. 7638 date 19.12.1992 "Për shoqëritë tregtare", si dhe çdo dispozite tjetër ligjore te cilës i behet referim ne ketë kontrate.

Kjo kontrate pasi u lexua prej meje Noterit, u gjet ne përputhje me vullnetin e lire e te plote te palëve dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre ne praninë time ne pese kopje origjinale dhe unë Noteri e vërtetoj ketë sipas ligjit.

SHITESI

BLERESI

Dod Doçi

Dod Doçi

Hydajet Rusta

Hydajet Rusta

NOTERI

NOTERE
Mimoza Saduhalaj
TIRANE



elda shuraja

From: Harito Qirko [HQirko@sial.com]
Sent: Friday, December 15, 2006 5:43 PM
To: elda.shuraja@hmh-al.net

Ne vemendje te Elda Shuraja,

Me anen e ketij email-i ju confirmoj se jam vene ne dijeni per mbledhjen a dates 13.11.2006 ora 11:00 me objek :

- Miratimi i transferimit to 2% to kapitalit nga Z. Dod Doci tek Z. Hydajet Rusta.
- Te ndryshme

dhe te mbledhjes se dates 26.07.2005 ora 11:00 me rend dite:

- Zgjedhja e anetareve to Keshillit Mbikqyres
- Te ndryshme.

Falemderit,

Harito Qirko